



NA KONTAKTONI NËSE...

...fëmija juaj shfaq sjellje të pazakontë, si p.sh.:

EDUKIMI I VEÇANTË NË FAZËN E HERSHME

- zhvillim të ngadaltë, lojëra në mënyrë të çuditshme
- shmangie të kontaktit me sy dhe kontaktit fizik
- të bërtitura të vazhdueshme dhe pothuaj pamundësi për të ruajtur qetësinë
- shfaqje të shenjave të plogështisë ose sjelljes tepër të edukuar
- vështirësi në komunikim ose kontakt, ankth të konsiderueshëm, mungesë izolimi emocional
- probleme afatgjata ngrënieje dhe fjetjeje
- bëhet ngacmues, bën "lëvizje nervozizmi", "sjellje tiranizuese"
- rrezik zhvillimi të fëmijës për shkak të një traume të madhe familjare

LOGOPEDIA NË FAZËN E HERSHME

- përvetësim i vonshëm i gjuhës, flet vetëm disa fjalë
- shqiptim i pasaktë i fjalëve
- renditje e gabuar e fjalëve ose shprehje me fjali jo të plota
- mangësi në kuptimin e udhëzimeve ose pyetjeve verbale
- belbëzim për një periudhë të gjatë
- komunikim i dobët me fëmijët e tjerë ose
- të rriturit, mbyllje në vetvete ose shfaqje agresiviteti

Ju lutemi, mos hezitoni të na kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje:

Thomas Holzer dhe ekipi
056 648 45 31, hpd@josef-stiftung.ch

Heilpädagogischer Dienst (HPD)

Früherziehung
Frühlogopädie Freiamt
Badstrasse 4
5620 Bremgarten
josef-stiftung.ch



Për
kë...?

... **edukim i veçantë në fazë të hershme** për foshnja dhe fëmijë të vegjël me aftësi të kufizuara, anomali në sjellje dhe probleme të përgjithshme zhvillimi, që nga lindja deri në fillimin e shkollës.

... **logopedi në fazë të hershme** për fëmijët nga mosha dyvjeçare derisa fillojnë kopshtin, të cilët kanë vonesa në të folur dhe çrregullime zhvillimi të të folurit ose të cilët rrezikojnë të kenë çrregullime në përvetësimin e gjuhës.

Ne ofrojmë edukim të veçantë në fazë të hershme dhe logopedi në fazë të hershme për fëmijët nga qarku i Bremgarten dhe Muri. Shpenzimet mbulohen nga kantoni.

Ndihmë e shpejtë

Mbështetje e shpejtë

SHËRBIMET E EDUKIMIT TË VEÇANTË EDUKIMI I VEÇANTË NË FAZË TË HERSHME LOGOPEDIA NË FAZË TË HERSHME

...ne **vlerësojmë**
... ne **mbështesim**
... ne **këshillojmë**

Ne ofrojmë mbështetje për fëmijët e vegjël me probleme të përgjithshme zhvillimi ose me vonesë në të folur, si dhe këshilla për prindërit.



Ne
vlerësojmë...

Ne
mbështesim...

Ne ju
këshillojmë...

... fuqitë dhe dobësitë që shfaq fëmija juaj. Gjatë **edukimit të veçantë në fazë të hershme**, ne vlerësojmë aftësitë e fëmijës suaj në të gjitha fushat zhvillimore ndërsa gjatë **logopedisë në fazë të hershme**, fokusohemi te gjuha dhe komunikimi. Hapat e mëpasshëm i diskutojmë së bashku me ju. Vlerësimi përbën bazën për këshillimin dhe mbështetjen e synuar.

...aftësitë e fëmijës suaj me aktivitete argëtuese. Ju, si prindër, përfshiheni në nxitjen e zhvillimit të fëmijës suaj. Në **edukimin e veçantë në fazë të hershme**, ne i mbështesim fëmijët me lojëra dhe me aktivitete që nxisin të menduarit, lëvizjet, ndërgjegjësimin dhe sjelljen sociale. Në logopedinë **në fazë të hershme**, ne nxisim aftësitë folëse dhe komunikuese të fëmijës. Synimet edukative i arrijmë në bashkëpunim me ju. Terapia e fëmijës zhvillohet kryesisht në ambientet e shtëpisë suaj, por edhe në qendrën tonë edukative, mbi baza individuale ose grupesh të vogla.

...juve mbi mënyrat se si mund të nxisni edukimin dhe zhvillimin e fëmijës suaj. Në **edukimin e veçantë në fazë të hershme**, ne punojmë së bashku me ju për gjetjen e zgjidhjeve për fëmijët me probleme në sjellje ose zhvillim. Në **logopedinë në fazë të hershme**, ju ndihmojmë që të nxisni zhvillimin e komunikimit dhe të gjuhës së fëmijës suaj.

Ne këshillojmë edhe drejtuesit e grupeve të lojës, stafin e kujdesit të përditshëm dhe specialistët e tjerë.